



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:817/26 Datë: 29.05.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 148 të mbajtur më 20.04.2026, mori:

V E N D I M

- I.** Nuk riakreditohet specializimi "*Mësimdhënia e fizikës*" i programit të studimit *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS*, i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës.
- II.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës ka parashtruar kërkesë Nr.prot.355/25 datë.07.04.2025 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e specializimit "*Mësimdhënia e fizikës*" në programin të studimit: *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS*, i akredituar me vendimin e KShC-së Ref.: **1519/24** Datë: **05/08/2024**. Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës kishte propozuar për akreditimin e specializimit të programit me stafin akademik/bartësit si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Master në mësimdhënien lëndore,</i> specializimi në " <i>Mësimdhënia e fizikës</i> "	Prof. Dr. Naim Syla

Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës në kërkesën e parashtruar kishte arsyetuar se citojmë: ...kërkon nga Agjencia e Akreditimi, të shqyrtoj mundësinë që të organizohet një vlerësim i llojit "follow-up" për programin master *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS me specializime* me qëllim që të shtohet specializimi "Mësimdhënia e fizikës". Ky program "*Master i mësimdhënies lëndore*" ka pasur tradicionalisht 8 specializime por në ri-akreditimin e fundit (1 tetor 2024- 30 shtator 2027) nuk arriti të përfshihet specializimi i mësimdhënies së fizikës. Kjo ndodhi për shkak të faktit që profesori që ishte bartës në këtë specializim në periudhën paraprake kisht përsuar një aksident me fatalitet. Pas dështimit për të rekrutuar një profesor me kualifikime të duhura të fushës në kohën e mbetur, erdhëm në situatë që mos të përfshijmë këtë specializim në aplikimin e fundit për riakreditim të programit.

Në bashkëpunim me Departamentin e Fizikës në Universitetin e Prishtinës (FSHMN), ka gjetur modalitetin e bashkëpunimit me departamentin për të shfrytëzuar resurset dhe stafin për realizim të përbashkët të këtij programi me interes të përbashkët, duke ditur që mbyllja e këtij specializimi ka ndikime edhe në kuadrot bachelor të këtij departamenti që synojnë një karrierë si mësimdhënës (meqë kërkesa ligjore aktualisht kërkon kualifikim master në mësimdhënien e fizikës për tu punësuar në shkollë). Riakreditimi i këtij programi do të mënjanoj presionin për të siguruar rrugën e kualifikimit të mësimdhënësve të fushës e cila edhe ashtu është duke u përballur me mungesë kuadrosh që janë esenciale për mësim të nxënësve. Bartësi i propozuar i këtij specializimi është Prof. Dr. Naim Sylja nga Departamentin e Fizikës në Universitetin e Prishtinës (FSHMN).

Me qëllim të vlerësimit të specializimit të proogramit të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspert ndërkombëtarë përmes procedurës së pas akreditimit (Follow UP) për riakreditimin e specializimit "*Mësimdhënia e fizikës*" në programin të studimit: *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS*.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm, Rregulloren (AKA)Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit) dhe Rregullore Nr.04/2025 për Monitorim dhe Procedura Pas-akredituese të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, eksperti ndërkombëtar ka hartuar raportin e vlerësimit për këtë specializim dhe ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për riakreditimin e specializimit "*Mësimdhënia e fizikës*" në programin të studimit: *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS*, me datë 03.03.2026 është organizuar vizita me ekspertin ndërkombëtar, i cili ka konstatuar se me gjithë mungesat e stafit akademik për këtë specializim, për shkak të nevojave të tregut të punës për mësimdhënës të fushës së fizikës, mund merret në konsideratë një rekomandim pozitiv për akreditim.

Megjithatë KShC pas verifikimit të stafit akademik dhe bartësit të propozuar si dhe referuar gjetjeve në raportin e ekspertit ka konstatuar se programi ka mungesa të evidentuara të cilat janë themelore për akreditimin e programit/specializimit.

Tutje ka konstatuar se bartësi i propozuar Prof. Dr. Naim Syla është i fushës së fizikës por nuk ka përvojën e mjaftueshme në didaktikë dhe mësimdhënie për zhvillimin e programit – procesit mësimor. Po ashtu stafi i përfshirë në mësimdhënie dhe ushtrime nuk i plotësojnë kriteret ligjore për të zhvilluar këtë program.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 148-të, të mbajtur më datë 20.04.2026, ka shqyrtuar kërkesën e Fakultetit të Edukimit në Universitetit të Prishtinës, dhe si organ vendimmarrës pas gjetjeve të evidentuara në raportin e ekspertit, arsyetimeve për nevojat e tregut dhe pretendimit se programi mund të avancoj në vazhdimësi, ka ardhur në përfundimin se ky specializim **"Mësimdhënia e fizikës"** në programin e studimit: *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS* **nuk akreditohet**, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

